



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLIGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërisë CIRCOR International, Inc. nga KKR & Co, Inc. nëpërmjet shoqërisë Cube BidCo, Inc.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 369 prot. i AK, datë 04.07.2023 “Njoftim Përqendrimi: Blerja e 100% të aksioneve të CIRCOR International nga CUBE BIDCO, INC”.

Referuar “Marrëveshjes dhe Planit të Bashkimit”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala Blerëse: Cube BidCo, Inc., një korporatë e themeluar për një qëllim të caktuar (SPV), në shtetin e Delaware, e cila zotërohet plotësisht në mënyrë indirekte nga shoqëri fondi investimesh, instrumenta dhe/ose llogarive të kontrolluara dhe administruara nga shoqëria KKR & Co, Inc.

KKR & Co, Inc. është një shoqëri investimesh globale, e cila merret me administrimin e aseteve alternative, si dhe ofron zgjidhje në tregun e kapitaleve dhe sigurimeve.

Cube BidCo, Inc. zotëron plotësisht shoqërinë Cube Merger Sub, Inc., korporatë në shtetin e Delaware, e themeluar posaçërisht dhe vetëm për qëllime të këtij transaksioni, e cila nuk ka kryer asnjë aktivitet biznesi.

Shoqëria Target: CIRCOR International, Inc. është një shoqëri e listuar me ofertë publike, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të shtetit të Delaware, e cila projekton, prodhon dhe shet produkte dhe nën-sisteme teknologjike të dalluara për tregjet industriale, ajrore dhe mbrojtjes.

Si pala blerëse, ashtu edhe shoqëria target nuk kanë shoqëri të kontrolluara, të regjistruara në Shqipëri por gjenerojnë xhiro në Shqipëri, nëpërmjet shitjeve indirekte, që kryejnë shoqëritë e kontrolluara prej tyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilave duhet respektivisht të realizohen ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit, si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.